

Apolonia nëpër analet e historisë / *Apollonia dans les annales de l'histoire*

Aleksandra Mano

Citer ce document / Cite this document :

Mano Aleksandra. Apolonia nëpër analet e historisë / *Apollonia dans les annales de l'histoire*. In: Iliria, vol. 31, 2003. pp. 149-162;

doi : <https://doi.org/10.3406/iliri.2003.1049>

https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_2003_num_31_1_1049

Fichier pdf généré le 19/03/2019

Aleksandra MANO

APOLONIA NËPËR ANALET E HISTORISË

Bibliografia për qytetin antik të Apolonisë është relativisht e gjerë dhe e shumanshme. Nuk pretendoj që në një kumtesë të jenë shfrytëzuar të gjitha burimet e shkruara që bëjnë fjalë për këtë qytet siç mund të kërkohet nga titulli.

Kam hezituar në fillim të marr përsipër trajtimin e kësaj kumtese: “*Apolonia nëpër analet e historisë*”, jo aq për shtrirjen dhe kompleksitetin e temës, se sa për vështirësinë që paraqet renditja e të gjitha të dhënave që mund të nxirren nga këto anale ose për të afruar interpretime të reja të tyre, që në shumë raste do të kërkonim studime të veçanta e më të thelluara. Pra për aq sa na lejon koha po paraqes shkurtimisht atë që kam trajtuar më gjerësisht në një studim tjetër (*Vështrime historike mbi Apoloninë e Ilirisë*, në proces botimi).

Për historinë antike të Apolonisë ka të dhëna me vlerë nga autorët e lashtë grekë e latinë. Në përgjithësi ato janë të kufizuara, fragmentare dhe të përqendruara më tepër në ngjarjet politike dhe luftarake të kohës.

Lajmet e para për Apoloninë e Ilirisë i kemi që në shekujt VI-V p.e.sonë nga historianë të shquar grekë: *Hekateu i Miletit*, historian dhe gjeograf i shek. VI p.e.s. në veprën e tij *Europa*, përmend Apoloninë si qytet me tipare të një polisi.

Në veprën e Herodotit *Historia* (Libri IX,92,93,94) gjejmë të dhëna me interes për tokat, kullotat, rritjen e dhenve, për legjendat, mitet, kultet, orakujt si dhe mënyrën e jetesës në Apoloni.

Te Thuqididi kemi vetëm një njoftim të shkurtër në të cilin thuhet se Apolonia ishte koloni e korinthisve (*Historia*, libri I, 26,2).

Në shekujt që pasojnë, gjatë periudhës helenistike dhe më vonë shtohet muri i lajmeve për këtë qytet. Midis njoftimeve me karakter gjeografik për krahinat bregdetare të Ilirisë që japin *Skylaksi* (Ps. Seyl. Periplus Illyriai, 26); *Skymni* (orbis descriptio, 435); *Straboni* (strab. Geographica, Libri VII, 8,5,4,7,7,57,a; Libri VIII, 32,3) dhe *Apollodori* (Apollod. Epic. 12,5b), nuk lënë pa përmendur Apoloninë dhe interlandin e saj.

Nga *Aristoteli* (Polit.Libri IV, 4; V,1) kemi kumtime të rëndësishme mbi organizimin shtetëror të Apolonisë si dhe disa njoftime të tjera me karakter ekonomik për Taulantët dhe fise të tjera që banonim në afërsi të qytetit Apoloni (Aristot. De mirab. Ausc. 832 a; 833 a; 839 b, 104; 842 b, 127,128).

Të dhëna të rëndësishme historike na japin Polybi dhe Tit Livi të cilët trajtojnë luftërat iliro-romake dhe ngjarje të tjera të viteve 229-146 p.e.sonë që u zhvilluan në trojet e Ilirisë së Jugut. Polyb, *Historiae*, Libri II, 9,1; 11,5; Libri V,109 (4-6); 110 (1-5); Libri VII,9 (1-14); Liv.Ab.urbe condita, Libri XXIV, 40(1-17); Libri XXVI, 25(1-2); Libri XXIX, 12(1-14); Libri XXXI,18(9); 27(1-8); 33(1-11); 40(4-6); Libri XXXIII, 3(9-10o), 34(1-11); Libri XXXVIII, 1,3(6-9); Libri XLII, 36(8); Libri XLIII, 21; Libri XLIV,30(10-14); Libri XLV,17(1-4), 18(3-8), 43(10). Në këto lajme bëhet fjalë dhe për, qëndrimin që mbajti Apolonia dhe banorët e saj gjatë kësaj periudhe plot me kontradikta të thella e konflikte të armatosura midis fuqive më të rëndësishme të botës mesdhetare, Ilirisë dhe Maqedonisë nga njëra anë dhe Romës nga ana tjetër.

Në ligjëratat e oratorit të shquar Ciceroni kundër M.Antonit, (cicër. M.Anton, 11) veçojmë cilësimin e tij për Apoloninë si një qytet të madh e hijerëndë ("*Magna urbs et gravis*"), ndërsa në një ligjëratë tjetër kundër Pisonit, oratori romak jep të dhëna me shumë vlerë për shfrytëzimin e egër dhe shkatërrimin që pësuan gjatë sundimit romak shumë krahina dhe qytete të Ilirisë, midis të cilave edhe Apolonia. (cicër.Pison. 35,40).

Ditari i Jul Cezarit mbi luftën civile paraqet interes të veçantë për historinë e Apolonisë në vitet 40-50 p.e.s. Lufta e përbashkët midis Cezarit dhe Pompeut, që kishte filluar në Itali, zhvillohet më pas në krahinat midis Apolonisë dhe Dyrrahut. Në këtë ditar gjejmë të dhëna të rëndësishme mbi gjendjen e rëndë ekonomike në krahinat ku ishin vendosur ushtritë ndërluftuese si dhe për përkrahjen që i dha paria apoloniote Cezarit gjatë luftës Civile.(Caes.B.Civ.Libri III,5(12); 6(1-13); 11(1-0.4); 12(1-4); 13(1-6); 25(1-2); 42(1-5); 75(1-5); 78(1-6); 79(1-3).

Nga fragmentet e ruajtura së biografisë prej August Oktavianit të Nikolla Damaskut (Fragmenta, 17,105) informohemi mbi disa privilegje dhe për një autonomi që iu dha Apolonisë nga perandori Oktavian Augusti, i cili kishte kryer dhe studimet në këtë qytet.(Paterc, *Historia Romana*, Libri II,4; Svet.Aug.Libri II,2(8); 1(89); 12(94).

Mirënjohjen ndaj qytetit, që i kishte dhënë arsim e kulturë, si dhe përkrahje në çaste të vështira, perandori i ri Oktaviani për këto do ta shpallte Apoloninë *Civitas libera et immunis*. Me dhënien e statusit "të një qyteti të lirë" disa qyteteve e krahinave ilire, midis të cilave edhe Apolonisë, Roma synonte forcimin e pozitive të saj në Iliri dhe Ballkan, duke krijuar baza të rëndësishme ushtarake dhe aleatë të mundshëm për veprimet luftarake të mëvonshme në këto treva.

Gjatë shekujve të parë të erës sonë sundimtarët romakë bëjnë përpjekje për të vendosur një stabilitet politik dhe ekonomik në krahinat e pushtuara. Tek autorët latinë të kësaj periudhe si Plini, Dion Kasi, Eliani etj., gjejmë të dhëna të rëndësishme mbi gjeografinë dhe ekonominë e Ilirisë, si dhe njoftime mbi praninë e asfaltit në trevën përrreth Apolonisë.(Plin, *Naturalis Historia*, Libri XVI, 12(23); libri XXIV, 7(25); Libri XXXV, 15(51); Cass.dio. *Historia Romana*, Frag.libri XLI, 1(45); Ael.*Vara Historia*, Libri XIII,16).

Për shek.II-III të e.sonë kemi mungesë të ndjeshme të burimeve të shkruara për Apoloninë.

Nga itineraret e shek.III-IV të Antoninit, Burdigales dhe Tabela Peuntigeria-

nës kemi burime të rëndësishme për studimin e rrugëve antike si p.sh. rruga Egnatia, që lidhej edhe me Apoloninë. Itinerarum Antonini Augusti. 329 (1-10). Cuntz.IR, f.49-50; Itinerarum Burdigalense, 607(1-10)-Cuntz.IR, f.49-50.; Tabula Pentingeriana, Miller IR. Col.559-569.

Gjatë antikitetit të vonë (shek.IV-V) kur perandoria Romake po përjetonte çastet më kritike të jetës së saj, veprimtaria e historianëve shtohet për të pasqyruar ngjarjet e kohës, ndërsa njoftimet për Apoloninë janë ende të pakta. Të dhëna indirekte për pasojat e dyndjeve barbare në Ilirik, mund të nxirren nga Marcelini, Hieronimi, Klaudiani, Orosi etj. Te kodeksi i Theodorit dhe i Justinianit gjejmë dhe informata me karakter ekonomik, shoqëror dhe juridik për Apoloninë në shek.V-VI të erës sonë. (Amm.Marcel. *Res gestae*: Libri XVII,13; Libri XIX, 7,9,10,12,13; Libri XXIV,1; Libri XXVI, 5,7,8; Libri XXX,7. Euseb. *Epist.*, 16,14; De Viris, CVII, CXXXV, *Sopli*. I; chron 8, XXXVIII; Claud. Carmina V (36-50); XV(451); XX(213-218); XXII(184,185,190-207); XXVI (518-542); Oros, libri I(12) 54,55,57,59; Libri VII(22) 6,7(23) 1,3,4 (24) 10,15,16; Cod.Theod. Libri I,29, 1; 32,5; Libri III 14,1; Libri VI,2,14; 4,11; Libri VIII 5,28; Libri X 10,25; Libri XI 3,2; 11,1; 17,14; Libri XVI, 8,12,21; Just.*Cod*. Libri I,3,35; 29,4; Libri II 4,43; Libri IV 41, 1,2,; 43 2; 63,2; Libri VI 38,5; Libri XI 38,5; Libri XI 53,1; Libri XII 57,9; NOV. VIII, XXXIII, kap.III, CXXXI; CLIII, kap.I.).

Në përgjithësi në literaturën ekzistuese pranohet *ex silentio* se rënia dhe shkatërimi i Apolonisë ka filluar në shek.III-IV të erës sonë, por kjo nuk do të thotë se u zhduk krejt.

Të vetmin burim për Apoloninë në shek.VI të e.sonë na e jep Stefan Bizantini i cili e cilëson Apoloninë si qytet të Ilirisë. Është po ky autor që na informon për emrin Gylakea, që mori Apolonia nga Gylaku, i cili kryesonte 200 korintas të dërguar për kolonizimin e Apolonisë. Nuk ka dyshim se këto lajme të Stefan Bizantinit i referohen një periudhe kohe shumë më të hershme, shek.VI p.e.sonë.(Stef. Biz. *Ethnica*, S.V.Apolonia, Gylakea).

Pas ndarjes së perandorisë Romake në vitin 395, Iliria e mesme dhe ajo jugore përfshihen në dy provinca që i përkisnin perandorisë së Lindjes; në jug Epiri i Vjetër (Epirus Vetus) me qendër Nikopolis dhe në veri Epiri i Ri (Epirus Novas) me kryeqendër Dyrrakionin. Kufiri midis këtyre dy provincave kalonte në jug të Vlorës (Aulona). Apolonia bënte pjesë në provincën e Epirit të Ri.

Përsa i përket politikës kishtarë të dyja provincat kishin lidhje me Papën dhe administroheshin nga Vikari i tij në Thesalonik, derisa në vitet 752-757, perandori Konstandin V, vuri në krye Patriarkun e Konstandinopolit, i cili administronte dhe dy provincat e Epirit (Heide und Helmut Buschhausen, *Die Marien Kirche von Apolonia in Albanien*, Wien 1976, f.29; Shih dhe literaturën e cituar prej tyre në shënimin 27).

Për invazionet barbare dhe shkatërrimet që rrodhën prej tyre në Gadishullin Ballkanik në fund të shek.IV dhe në fillim të shek.V, nuk kemi të dhëna që ta kenë prekur drejtpërsëdrejti dhe Apoloninë, por nuk përjashtohet mundësia që edhe në territorin Apolonia të kenë vërshuar një numër i konsidrueshëm të ikurish nga krahinat e ndryshme të Perandorisë. Në kohën e inkursioneve të gotëve në vitet 440-450 si edhe më vonë gjatë sundimit të tyre në fillim të shek.VI, Apolonia ka

pësuar pak a shumë të njëjtin fat si dhe qytetet dhe provincat e tjera të Ballkanit perëndimor. Kështu kur Ostgoti Theodorik pushton Durrësin më 479, ka mundësi që në të njëjtën kohë ai të ketë vënë dorë edhe mbi Apoloninë.

Në kohën e Justinianit, Apolonia vazhdon të bëjë pjesë në provincat e Epirit të Ri, por nuk kemi të dhëna që të ketë ndihmuar Durrësin në përgatitjen e flotës dhe në grumbullimin e ushtrive perandorake bizantine kundra gotëve. (Procopii, *De bello Cothico* V,7 rec. Haury, Teubner 1905; G.Novak, *L'histoire de Dubrovnik*, I partie, Dubrovnik 1967, f.56,57.

Dyndja e madhe e popujve që pati vend mbas vdekjes së Justinianit, lejoi në fillim të shekullit VII filtrimin e bandave të armatosura dhe të popullsisve të tjera sllave të cilat siç dihet u përhapën dhe në territorin e Shqipërisë. Është pikërisht kjo periudhë që shumë qytete e qendra antike braktisen dhe popullsia e tyre tërhiqet e krijon vendbanime të tjera më të mbrojtura.

Kështu po t'u referohemi burimeve të kohës, rezulton se Apolonia në kohën pasantike, humbet dalëngadalë rëndësinë e saj të dikurshme dhe një pjesë e popullsisë tërhiqet në brendi të Mallakastrës, në Ballsh, ose në gjirin e mbrojtur të Vlorës. Është Aulona tashti që ka marrë plotësisht përsipër të luajë atë rol që kishte Apolonia në kohën antike në këtë zonë.

Zvogëlimi i rolit dhe i rëndësisë së Apolonisë duket qartë në kohën justiniane. Për këtë mjafton t'i hedhim një vështrim historisë kishtare të kohës.

Në koncilet kishtare të Efesit (v.431) dhe në atë të Kalkedonit (v.451), Apolonia përfaqësohet përkatësisht nga peshkopët e saj Feliks dhe Eusebius, ndërsa në koncilin e v.458 në Kalkedoni përmendet peshkopi Filoharis i Bylisit. (Heide und Helmut Buschhausen, vep.cit..., f.30).

Një shekull më vonë Apolonia bie në vartësinë kishtare të Aulonës, pozita e së cilës rritet dalëngadalë. Kështu në koncilin e pestë ekumenik të Kostandinopolit (v.553) është Aulona që dërgon peshkopin e saj Soterus.(Heide und Helmut Buschhausen, vep.cit..., f.39).

Por edhe pse Apolonia nuk ka atë shkëlqim dhe rëndësinë e dikurshme, prapsepapë jeta në këtë qendër, nuk u shua krejt, ajo ka vazhduar, sigurisht jo me atë të intensitet të shekujve të mëparshëm.

Për ekzistencën e Apolonisë si qytet gjatë shekujve VI-X kemi tri burime: Hierokli, Anonimi i Ravenës dhe Konstandin Porfirogjeneti.

Po t'i hedhim një sy guidës së Hieroklit, vëmë re se provinca e Epirit të Ri në kohën e Perandorit bizantin Justinianit kishte 9 qytete midis të cilave përmendet dhe Apolonia (Hierocl. Synecdemus 8, XIII, 653, 3).

Një autor tjetër i shek.VII-VIII, Anonimi i Ravenës, në veprën e tij "Kosmografia" përmend shumë emra gjeografikë të Ilirisë midis të cilëve edhe qytetin e Apolonisë (Rev. Cosmografia V,13,15).

Konstandin Porfirogjeneti, perandor bizantin i shek.X në veprën e tij "Mbi Themat" duke bërë fjalë për themën e Durrësit, përmend dhe Apoloninë si një nga 9 qytetet e kësaj theme (Constandin Porphyrogeneti, De Thematibus occidentis, libër II, f.21).

Në përgjithësi informatat për Shqipërinë e mesme në kohën e mesjetës së hershme janë shumë të varfëra. Rrjedhimisht edhe njoftimet për Apoloninë deri në

shek.XV pothuajse shterojnë krejt. Megjithatë në këtë rast vijjnë në ndihmë dokumentet bizantine që bëjnë fjalë për ngjarjet historike më të rëndësishme, që kanë përfshirë trojet shqiptare në këtë kohë, e sidomos ato që kanë të bëjnë me Myzeqenë dhe Mallakastrën.

Po t'i referohemi mbishkrimit të Ballshit të vitit 866, rezulton se, bullgarët mbas paqes së vitit 864-865, që bëri Cari i tyre Boris Mihail, me perandorin bizantin Mihail III, kishin dalje në detin Adriatik. Aty nga viti 896-Cari Simeoni i Bullgarisë pushtoi 30 kështjella në Dyrakion, duke i zgjeruar edhe më shumë zotërimet bullgare në Shqipërinë e mesme. Megjithatë nuk është e sigurtë nëse përfshihej edhe Apolonia në pushtimet bullgare.

Sipas Ana Komnenës, (Ana Comnene, Alexias, Libri I,14; Libri III,12 dhe libri XII,9) e cila bën fjalë për pushtimet e normanëve në Shqipëri në vitet 1081 deri 1085 dhe 1107-1108) rezulton se e gjithë Shqipëria e mesme nga Vlora në Durrës bëhet objekt sulmesh, plaçkitjesh e shkatërrimesh prej normanëve. Nuk ka dyshim që edhe Apolonia të ketë pësuar një fat të tillë.

Nën Manuelin I Komnenos, Shqipëria e Mesme, sidomos limani i Vlorës dhe ishulli i Korfuzit shërbyen si bazë për operacionet normane dhe bizantine në Epir dhe në Itali.

Pas përmbysjes së Perandorisë Bizantine më 1204, në Epir krijohet një shtet i ri "*Despotati i Epirit*" në pjesën veriore të të cilit përfshiheshin krahinat e Shqipërisë së sotme deri në Durrës. Sundimi i latinëve në Konstandinopol, solli ndryshime në raportin e forcave në Ballkan. Pikërisht në këtë kohë del në skenë dhe gjallërohet Republika e Venedikut, e cila kërkonte të kishte nën ndikimin e vet qytetet bregdetare përgjatë Adriatikut. Ajo fillon të zgjerojë zotërimet e veta edhe në bregdetin shqiptar, merr provincën e Durrësit bashkë me Glavenicën, Vlorën, Spinarcën (skelë mesjetare në derdhjen e lumit Vjosë) etj. Ka shumë të ngjarë që Apolonia të ketë qenë përfshirë përkohësisht në zotërimet venedikase, megjithëse në dokumentet e kësaj kohe nuk del qartë se ku bënte pjesë territori i Apolonisë, nën sundimin e Venedikut, apo në atë të despotatit të Epirit (Acta et diplomata I, 129 e 130; shih dhe Burimet e zgjedhura për Historinë e Shqipërisë, f.81, nr.27 e 28).

Edhe gjatë depërtimit të feudalëve të Evropës Perëndimore dhe sundimit të anzhuinëve në Shqipëri (1258-1336) kemi një situatë jo të qëndrueshme. Dokumentet mesjetare përmendin kryengritjet fshatare të viteve 1274 dhe 1336 kundra sundimit të nazhuinëve, të cilat u përhapën në tërë zonën nga Vlora, në Berat dhe në Durrës. Luftërat e vazhdueshme midis anzhuinëve dhe bizantit, kryengritjet e arbëreshëve dhe inkursionet e kryqëtarëve sollën shkatërrime dhe pasiguri në gjithë Shqipërinë e Jugut. Në vorbullën e këtyre ngjarjeve është përfshirë edhe Apolonia. Monedhat e sundimtarëve anzhuinë të gjetura në rrënojat e teatrit antik të Apolonisë tregojnë qartë se edhe Apolonia nuk u ka shpëtuar ngjarjeve të kohës, plaçkitjeve dhe grabitjeve kryqtare e bizantine (A.Mano, B.Dautaj, *Theatri i Apolonisë* (gërmime të vitit 1978) Iliria I, 1982, f.191,205).

Me sa duket gjatë kësaj periudhe territori i Apolonisë duhet të ketë qenë përfshirë herë nën bizantin dhe herë nën zotërimet e feudalëve frengj anzhuinë, para se të kalonte nën zotërimet e familjes feudale shqiptare të Muzakajve. Afresku në kishën e Shën Mërisë në Apoloni ku paraqitet familja perandorake e Andronikut II

Paleologut tregon qartë se nga fundi i shekullit XIII-fillimi i shekullit XIV Apolonia bënte pjesë në Perandorinë Bizantine. Kjo rezultoi edhe nga një dokument i vitit 1297, në të cilin bëhet fjalë mbi ankesën e tregtarëve raguzanë kundër Matarangëve të Polinës që ishin në varësinë e perandorit bizantin. Ky dokument përbën dhe të vetmin burim që kemi për Apoloninë nga mesjeta e hershme (Shih H.und H.Buschhausen, vep.cit., f.34).

Me vdekjen e Andronikut III më 1341 në Konstandinopol krijohet një gjendje e vështirë në oborin perandorak bizantin, të cilën e shfrytëzoi Cari i serbëve Stefan Dushani. Ky filloi menjëherë zgjerimin e mbretërisë së tij duke pushtuar trojet shqiptare; më 1343 pushtoi Krujën, më 1345 Beratën dhe Vlorën dhe më 1348 gjithë Epirin. Gjurmë të ndikimit serb janë vënë re në afresket e Trapezarisë në kishën e Shën Mërisë të Apolonisë (H.und H.Buschhausen, po aty., f.15).

Në gjysmën e dytë të shek.XIV, një rrezik tjetër më i madh i kërcënohet vendit tonë dhe gjithë Evropës nga lindja. Hordhitë turke mbasi pushtuan Adrianopolin më 1362, vërshojnë nëpër Ballkan dhe më 1417 pushtojnë Vlorën, limani i parë për turqit në Adriatik. Nëpër analet e mesjetës, në veprat e historiografisë evropiane, ku bëhet fjalë për rrezikun që i kërcënohet Evropës nga pushtimet turke, ndër të tjera përmendet edhe Apolonia, gjiri i Ambrakisë, etj., si pika nga niseshin rrugët e ushtrive turke për në Itali. (Bessario, N.C.Orationes de gravissimis periculis, quae Reipublica Christianae a Turcis iam tum im ndere providebat..., Romae 1543, f.21). Apolonia përmendet gjithashtu edhe në luftën e sulltan Mehmetit kundër Apulisë (Lucanus, A.J., *De gestis rerum Neapo*, Neapoli 1566, f.41, 49). Një historian tjetër i shek.XVII e konsideron Apoloninë si një qytet të lashtë e të rëndësishëm në kohën e pushtimeve turke. (Sansovino, F., *Historia universale dell'origine et della guerra Turchi*, in Venetia 1654, f.153, 302).

Apolonia si një qendër me kulturë e tradita të lashta nuk mbetet pa u vënë re nga humanisti italian i shekullit XV, Qiriaku i Ankonës. Gjatë vizitës që ky shtegtar bëri në Shqipërinë e Jugut në vitin 1435, ai grumbulloi objekte të ndryshme antike dhe kopjoi një sërë mbishkrimesh midis të cilave edhe një mbishkrim latin me prejardhje nga Apolonia. (CIL, III, 1-601, shih edhe P.C.Sestieri, *Mbishkrime latine të Shqipërisë*, në studime e tekste dega II arkeologjike nr.1, Tiranë 1943, f.10; H.Ceka e S.Anamali, *Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë në BUSHT Sh Sh*, 1, 1961, f.106, shën 6).

Një njoftim të rëndësishëm për Apoloninë e kemi nga humanisti i shquar shqiptar i shek.XV-XVI, Marin Barleti. Në veprën e tij për jetën e Gjergj Kastriot Skënderbeut kur bën fjalë për Kuvendin e Lezhës, Barleti, ndër të tjera na bën të ditur dhe emrat e qyteteve që ishin në konsideratë dhe më të përshtatshëm për organizimin e Kuvendit dhe të Besëlidhjes shqiptare. Midis qendrave më të rëndësishme të asaj kohe si Kruja, Danja, Lisos dhe Zhabjaku përmendet dhe Apolonia si një nga qendrat e mundshme për selinë e këtij Kuvendi. Nga kjo që na kumton Barleti, del se Apolonia në kohën e Skënderbeut, ka qenë një qendër jo pa rëndësi. Ajo përfshihej në zotërimet e Muzakajve, që ishin nga familjet shqiptare më të njohura të asaj kohe. Si e tillë ajo i kishte kushtet që të radhitej midis vendeve pretendente për qendrën e beslidhjes dhe të bashkimit të të gjithë bujarëve shqiptarë në luftë kundër turqve.

Për një kohë të gjatë prej afro dy shekuj (XVII-XVIII) gjatë pushtimit të gjatë osman, Apolonia bie pothuajse në harresë të plotë dhe shumë rrallë përmendet në kronikat e kohës. Në luftën veneto-turke të vitit 1570-1571, me sa duket Apolonia konsiderohej si një pikë e rëndësishme strategjike për të dyja palët ndërluftuese (Gratianus, A.M., *De bello cyprio*, libri V, Romë 1624, f.132). Historiani italian Sansovino në librin e tij për historinë e pushtimeve turke e konsideron Apoloninë si një qytet të lashtë e të rëndësishëm (Sansovino, F., *Historia universale dell'origine et delle guerra Turchi*, Venetia 1654, f.153, 302).

Por reminishencat nga shkëlqimi i dikurshëm i Apolonisë sa vijnë e pakësohen derisa qyteti “madhështor e hijerëndë” braktiset dhe rrënojat e tij për shekuj me radhë kthehen në gurore të vërteta. Veç grabitjeve e shkatërrimeve nga dora e njeriut, qyteti nuk u shpëtoi as pasojave të tmershme të natyrës. Nga kronikat e kohës informohemi për tërmete shumë të forta që ka pësuar zona bregdetare e Shqipërisë (në v.1273, 1284, 1444, 1617) të cilat kanë prekur edhe zonën e Apolonisë (Heide und Helmut Buschhausen, *Di Marien kirche...*, f.69-70; shih dhe literaturën e cituar prej tyre në shënimet 62-65).

Fundi i shek.XVIII dhe fillimi i shek.XIX shënojnë për Apoloninë fillimin e ringjalljes së saj.

Janë udhëtarë e studiues të huaj evropianë si Pukëvili, Lik e të tjerë që do të kërkojnë e zbulojnë në fshatin e sotëm Pojan (Fier) gjurmët dhe mbeturinat e mbetura të Apolonisë së lashtë. Me këta studiues pasionantë e kureshtarë fillon një kronikë tjetër, ajo e anave të kërkimeve për qytetin antik të Apolonisë, e cila do të përbënte një temë të veçantë për këtë simposium.

Shekulli XX shënon për historikun e Apolonisë epokën e gërmimeve të rregullta e sistematike.

Nuk ka dyshim se organizimi i këtij Simpoziumi është një nder i merituar që i bëhet arkeologut të shquar francez *Leon Rey*, i cili 80 vjet më parë filloi kërkime intensive në Apoloni. Gjatë 14 viteve ai nxori në dritë monumente të tilla si: odeonin, portikun, agonotetet etj., që janë nga perlat më të çmuara të antikitetit jo vetëm për Apoloninë, por për gjithë Shqipërinë. Këto monumente të mrekullueshme mund të krahasohen denjësisht edhe me ato të zbuluara në shumë qytete antike të botës mesdhetare.

Aleksandra MANO

APOLLONIA DANS LES ANNALES DE L'HISTOIRE^{1*}

La bibliographie sur la ville d'Apollonia est relativement riche et multiple. Et je ne prétends pas énumérer dans le cadre de cette contribution toute la tradition écrite mentionnant Apollonia comme son titre pourrait laisser entendre. J'ai longtemps hésité avant de préparer cette contribution non par la complexité et l'étendue du sujet « Apollonia dans les annales de l'histoire », mais surtout à cause de la difficulté que pose la présentation de toutes les données et leurs interprétations qui nécessitent des études spéciales et plus approfondies. Je ne donnerai donc ici qu'un bref aperçu de ce que j'ai traité ailleurs en détails (« Regards historiques sur Apollonia d'Illyrie », en cours de publication).

Sur l'histoire ancienne d'Apollonia existent des précieux indices chez les auteurs grecs et latins. Il s'agit avant tout de données limitées, fragmentaires et axées notamment sur les événements politiques et belliqueux de l'époque.

Les premiers indices sur Apollonia d'Illyrie remontent aux VI^e-V^e siècles av. J.C. par des historiens grecs réputés :

Hécatée de Milet, historien et géographe du VI^e siècle av. J.C. dans son œuvre *Europe* mentionne Apollonia comme ayant les caractéristiques d'une ville civilisée.

Dans l'œuvre d'Hérodote, *L'Histoire* (IX,92,93,94), on trouve des données intéressantes sur les terres, l'élevage, les légendes, les mythes, les cultes, les oracles et sur la façon de vivre à Apollonia.

Chez Thucydide, on trouve une brève mention d'Apollonia en tant que colonie corinthienne (*Histoire*, I,26,2).

Au cours des siècles et à partir de l'époque hellénistique, les informations sur cette ville deviennent plus nombreuses. Parmi les informations d'ordre géographique sur les régions côtières d'Illyrie, on trouve également des indices sur Apollonia et son arrière-pays chez Skylaks (*Ps.Scyl. Periplus Illyriai*, 26) ; Skymnos (*orbis descriptio*, 435) ; Strabon (*Strab. Geographica*, VII, 8,5,4,7,7,57,a et VIII,32,3) et Apollydore (*Apollod. Epic.* 12,5b).

Chez Aristote (*Polit.* IV,4 et V,1), nous trouvons des données importantes sur l'organisation politique d'Apollonia ainsi que quelques indices d'ordre économique sur la tribu des Taulantes et d'autres tribus situées dans le voisinage de la ville d'Apol-

¹ * Traduit de l'original par Marin Haxhimihali.

lonia (Aristot. De Mirab. Ausc. 832 a ; 833 a ; 839 b,104 ; 842 b, 127, 128).

Des informations historiques importantes sont également données par Polybe et Tite Live décrivant les guerres illyro-romaines et d'autres événements des années 229-146 ayant eu lieu sur le territoire de l'Illyrie Méridionale : Polyb, *Historiae*, II,9,1 ; V,109 (4-6) ; 110 (1-5) ; VII,9 (1-14) ; Liv.Ab. *urbe condita*, XXIV,40 (1-17) ; XXVI, 25 (1-2) ; XXIX, 12 (1-14) ; XXXI, 18 (9), 27 (1-8), 33 (1-11), 40 (4-6) ; XXXIII, 3 (9-10), 34 (1-11) ; XXXVIII, 1,3 (6-9) ; XLII, 36 (8) ; XLIII, 21 ; XLIV, 30 (10-14) ; XLV, 17 (1-4), 18 (3-8), 43 (10). Dans ces passages, il est également question des positions prises par les habitants d'Apollonia lors de cette période riche en troubles et en conflits entre les puissances du monde méditerranéen, l'Illyrie et la Macédoine d'un côté, et Rome de l'autre.

Dans les discours du célèbre orateur Cicéron contre Marc Antoine (Cicer. M.Antoni, 11), Apollonia a été définie comme une grande ville majestueuse : « *Magna urbs et gravis* », tandis que dans l'autre discours contre Pison, l'orateur romain donne de précieuses indications sur l'exploitation sauvage et les destructions subies durant la domination romaine par plusieurs régions et villes de l'Illyrie dont Apollonia (Cicer. Pison. 35,40).

Le journal intime de Jules César sur la guerre civile donne des informations d'une importance capitale sur la ville d'Apollonia dans les années 50-40 av. J.C. La guerre entre César et Pompée qui a débuté en Italie se poursuivait sur les territoires entre Apollonia et Dyrrachium. Dans ce carnet on trouve des données importantes sur l'état économique difficile dans les régions où étaient situées les deux armées, ainsi que des témoignages sur l'appui offert par les dignitaires d'Apollonia à l'armée de César durant cette guerre civile. (Caes. B.Civ. III,5 (12) ; 6 (1-13) ; 11 (1-4) ; 12 (1-4) ; 13 (1-6) ; 25 (1-2) ; 42 (1-5) ; 75 (1-5) ; 78 (1-6) ; 79 (1-3)).

Les fragments parvenus jusqu'à nos jours de la biographie d'Auguste Octavien écrite par Nicolas de Damas (fragmenta 17,105) nous apprennent que la ville d'Apollonia bénéficiait de certains privilèges et d'une autonomie accordée par Octavien Auguste qui y avait effectué ses études. Reconnaisant envers la ville qui lui avait permis d'accéder à l'éducation et la culture et qui l'avait soutenu dans des moments difficiles, le jeune empereur Octavien avait fait d'Apollonia une *Civitas libera et immunis*. A travers l'accord du statut de « ville libre » à certaines villes et régions de l'Illyrie dont Apollonia, Rome envisageait le renfort de ses positions sur l'autre rive de l'Adriatique et dans les Balkans. Cela permettait la création d'importantes bases militaires et des alliances possibles en vue de futures campagnes de conquête. Dans les premiers siècles de notre ère, les dominateurs romains essaient d'établir une stabilité politique et économique dans les régions occupées. Chez les auteurs latins de cette époque (Pline, Dion Cassius, Elianus, etc.) on trouve d'importantes indications sur la géographie et l'économie de l'Illyrie, ainsi que des témoignages sur la présence de bitume dans la région d'Apollonia.

Vers les II^e et III^e siècles de notre ère, il y a une absence notable de sources écrites concernant Apollonia. Dans les itinéraires des III^e et IV^e siècles d'Antonien, Burdigala et la Table de Peutinger, on trouve des indications importantes sur les routes antiques telles que la Via Egnatia qui reliait Apollonia : *Itinerarum Antonini Augusti* 329 (1-10). Cunz. IR. p. 49-50 ; *Itinerarum Burdigalense*, 607 (1-10) ; *Tabula Peun-*

tingeriana, Miller IR. Col. 559-569.

Durant l'Antiquité tardive (IV^e-VI^e siècles), alors que l'empire romain faisait face aux situations les plus critiques de son histoire, les œuvres des historiens se multiplient afin de tenir compte des événements de l'époque. Cependant les informations sur Apollonia sont peu nombreuses. On peut néanmoins obtenir quelques indications indirectes dans les œuvres de Marcelinius, Hieronymus, Claudien, Oros, etc..., notamment sur les conséquences des invasions barbares en Illyricum. Dans les codex de Théodore et de Justinien on trouve des informations d'ordre économique, social et juridique sur Apollonia dans les V^e et VI^e siècles. (Amm. Marcel. *Res gestae* : XVII,13 ; XIX, 7,9,10,12,13 ; XXIV,1 ; XXVI, 5,7,8 ; XXX,7. Euseb. *Epist.*, 16,14 ; De Viris, CVII, CXXXV, *Sopli*. I ; chron. 8, XXXVIII ; Claud. Carmina V (36-50) ; XV (451) ; XX (213-218) ; XXII (184, 185, 190-207) ; XXVI (518-542) ; Oros, I (12) 54, 55, 57, 59 ; VII(22) 6,7 (23) 1,3,4 (24) 10, 15, 16 ; Cod Theod. I,29,1 ; 32,5 ; III 14,1 ; VI,2,14 ; 4,11 ; VIII 5,28 ; X 10,25 ; XI 3,2 ; 11,1 ; 17,14 ; XVI, 8,12,21 ; Just. *Cod*. I,3,35 ; 29,4 ; IV 41, 1,2 ; 43, 2 ; 63,2 ; VI 38,5 ; X 38,5 ; XI 53,1 ; XII 57,9 ; Nov. VIII, XXXIII, chap. III, CXXXI ; CLIII, chap. I)

En général, il est admis dans les textes *ex silentio* que la chute d'Apollonia a débuté dans les III^e - IV^e siècles sans pour autant prétendre à un total démantèlement de la ville.

La seule source attestant l'existence d'Apollonia au VI^e siècle est Etienne de Byzance pour lequel elle est une ville d'Illyrie. Un autre chroniqueur, du nom de Gylakea, nous informe qu'Apollonia aurait été fondée par un certain Gylax à la tête de 200 Corinthiens. Il est évident que ces informations se réfèrent à une époque beaucoup plus ancienne (Stef. Biz. *Ethnica*, S.V. Apolonia, Gylakea).

Après la division de l'empire romain en 395, les Illyries centrale et méridionale faisaient partie de deux provinces appartenant à l'Empire de l'Est ; l'Epire Ancienne au Sud (*Epirus Vetus*), dont la capitale était Nicopolis et la Nouvelle Epire au Nord (*Epirus Nova*), dont la capitale était Dyrrachion. La frontière entre ces deux provinces passait au sud de Vlora (*Aulona*) et Apollonia faisait partie de la Nouvelle Epire.

Du point de vue ecclésiastique, les deux provinces étaient rattachées au Pape sous l'administration de son Vicaire à Thessalonique. Vers les années 752-757, l'empereur Constantin V a nommé un Patriarche à Constantinople qui du coup administra également les deux provinces d'Epire. (H. u. H. Buschhausen, *Die Marienkirche von Apolonia in Albanien*, Wien 1976, p. 29; voir également la bibliographie citée à la note 27).

En ce qui concerne les invasions barbares et les destructions qu'elles produisirent dans les Balkans entre la fin du IV^e et le début du V^e siècle, nous n'avons pas d'indices directs qu'elles auraient pu atteindre Apollonia. Mais on ne peut cependant pas exclure que le territoire d'Apollonia ait abrité des habitants d'autres régions de l'empire en fuite à cause des invasions. A l'époque des invasions des Goths, dans les années 440-450, et durant leur règne au VI^e siècle, Apollonia semble avoir subi plus au moins le même sort que les autres villes des Balkans occidentaux. De ce fait, il se peut que l'Ostrogoth Théodoric qui a occupé Dyrrachium en 479, puisse être également arrivé jusqu'à Apollonia.

A l'époque de Justinien, Apollonia faisait toujours partie de la Nouvelle Epire, mais il n'y pas d'indice sur un éventuel appui aux préparatifs de la flotte et de l'armée impériale de Dyrrachion contre les Goths. (Procopii, *De bello Gothico* V,7 rec. Haury, Teubner 1905 ; G.Novak, *L'histoire de Dubrovnik*, I, Dubrovnik 1967, p. 56 et 57).

La grande migration des peuples qui a eu lieu après la mort de Justinien a permis l'intrusion de bandes armées et d'autres peuplades slaves qui ont atteint l'actuel territoire albanais. Pendant cette période, plusieurs villes et autres centres habités sombrèrent dans l'abandon. Leurs populations se retirèrent vers d'autres habitats plus protégés. Les sources indiquent un abandon graduel d'Apollonia dont la population trouve refuge vers l'intérieur du pays, dans la région de Byllis (Mallakstra) ou bien dans la baie protégée de Vlora (*Aulona*). En effet Aulona joue désormais dans la région le rôle qu'Apollonia tenait durant l'Antiquité.

La diminution du rôle et de l'importance d'Apollonia est clairement visible durant l'époque justinienne. Les relations religieuses de l'époque le prouvent. Durant les conciles d'Ephèse (431) et de Chalcédoine (451), Apollonia se voit représenter par ses évêques Félix et Eusèbe, tandis qu'au deuxième concile de Chalcédoine en 458, l'évêque Philocharis représentait l'évêché de Byllis (H.&H. Buschhausen, p. 39).

Un siècle plus tard, Apollonia dépend du point de vue religieux d'Aulona (Vlora) qui renforce sa position régionale. Or, bien qu'Apollonia ait perdu pour beaucoup la splendeur de l'Antiquité, la vie ne s'est pas pour autant arrêtée dans cette ville. Trois sources historiques attestent l'existence de la ville d'Apollonia entre le VI^e et le X^e siècles : Hiérocès, l'Anonyme de Ravenne et Constantin Porphyrogénète. Si l'on consulte le guide de Hiérocès, on constate que la province de la Nouvelle Epire à l'époque de Justinien avait 9 villes dont Apollonia. (Hier. Synecdemus 8, XIII, 653,3). Un autre chroniqueur des VII^e-VIII^e siècles, L'Anonyme de Ravenne dans sa «*Cosmographie*» mentionne certains noms géographiques en Illyrie dont la ville d'Apollonia. (Rav. Cosmografia V,13,15). Constantin Porphyrogénète, empereur de Byzance au X^e siècle, dans son œuvre «*De Thematibus*», dans laquelle il décrit les 9 villes de la *thema* de Dyrrachion, y mentionne aussi Apollonia. (Constantin Porphyrogeneti, *De Thematibus occidentis*, I, p. 21).

Les informations sur l'Albanie centrale au haut Moyen-Âge sont très lacunaires. Les données sur Apollonia sont presque inexistantes jusqu'au XV^e siècle. Quelques indications indirectes viennent cependant des chroniques byzantines relatant des événements historiques ayant lieu dans les territoires albanais et concernant notamment la Myzeqé et la Mallakstra. Si l'on se réfère à l'inscription trouvée à Ballshi en 866, il apparaît que les Bulgares, après la paix de 864-865 que leur tsar Boris Michel avait conclue avec l'empereur byzantin Michel III, ont atteint la mer Adriatique. Vers 896, le tsar bulgare Siméon avait occupé 30 forteresses dans la région de Dyrrachion. Nous ne savons pas si Apollonia a figuré parmi les conquêtes bulgares en Albanie centrale.

D'après Anne Comnène (Ana Comnène, Alexias, I,14 ; III,12 et XII,9) qui fait le récit des invasions normandes en Albanie pendant les années 1081-1085 et 1107-1108, on comprend que toute l'Albanie centrale, de Dyrrachion à Vlora, a été l'objet d'attaques, de pillages et de destructions de la part des Normands. Cela ne fait aucun doute qu'Apollonia a dû subir le même sort. Sous Manuel Comnène, l'Albanie cen-

trale, mais surtout le port de Vlora et l'île de Corfou, étaient les points de départ des opérations normandes et byzantines en Epire et en Italie.

Après la chute de Byzance en 1204, s'est créé en Epire le « Despotat d'Epire » qui incluait les territoires albanais jusqu'à Dyrrachion. La domination latine à Constantinople apportait des changements dans le rapport de forces dans les Balkans. C'est à ce moment qu'entre en scène la République de Venise qui essayait d'établir son autorité sur toutes les villes du littoral. C'est ainsi qu'elle obtient la région de Dyrrachion, ainsi que Glavinitzza, Vlora et Spinaritzza (port médiéval sur la Vjosa), etc... Il est fort probable qu'Apollonia faisait également partie des possessions vénitiennes de l'époque. Les documents contemporains ne sont pas explicites sur une appartenance d'Apollonia aux territoires de Venise ou au Despotat d'Epire. [Acta et diplomata I, 129 et 130 ; voir également « Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë (Sources choisies sur l'histoire d'Albanie), p. 81, nr. 27 et 28].

Au XIII^e siècle, Charles I^{er} d'Anjou, roi de Sicile et frère du roi de France Saint Louis, essaya de rétablir l'empire latin de Constantinople et débarqua à Dyrrachium. La domination de la dynastie d'Anjou en Albanie (1258-1336) coïncida avec une période de troubles. Les documents médiévaux mentionnent les insurrections paysannes des années 1274 et 1336 dans les régions de Vlora, Berat et Dyrrachium. Les guerres répétées entre les Anjou et Byzance, les insurrections locales et les passages des Croisés ont apporté des destructions et l'insécurité sur toute l'Albanie méridionale y compris à Apollonia. Les monnaies angevines trouvées dans les ruines du théâtre antique d'Apollonia prouvent que la ville n'avait pas échappé aux troubles de l'époque. [A.Mano, B.Dautaj, *Theatri i Apolonisë* (gërmime të vitit 1978) - (fouilles de l'année 1978), Iliria I, 1982, p. 191-205.] Il est fort probable que pendant cette période, le territoire d'Apollonia passait tantôt sous domination byzantine et tantôt sous celle des Anjou avant de finir comme domaine de la maison féodale albanaise des Muzaka. La fresque de l'église de la Vierge Marie à Apollonia, où l'on peut voir la famille impériale d'Andronic II Paléologue, montre clairement que vers la fin du XIII^e et le début du XIV^e siècles, la ville faisait partie de l'empire byzantin. Cela est également attesté par un document de l'année 1297, où l'on trouve une plainte des commerçants de Raguse (Dubrovnik) à l'égard des Mataranga de Polina, assujettis à l'Empereur de Byzance. Il s'agit de l'unique document mentionnant Apollonia durant cette époque. (cf. H.& H. Buschhausen, p. 34).

Après la mort d'Andronic III en 1341, le tsar des Serbes, Etienne Dusan, a profité des troubles à la cour de Constantinople. Sans tarder, il a commencé à augmenter ses territoires en occupant les villes albanaises : Kruja en 1343, Berat et Vlora en 1345 et toute l'Epire en 1348. Des traces de l'influence serbe ont été attestées dans les fresques de la salle du monastère, dans l'église de la Sainte Vierge à Apollonia (cf. H.& H. Buschhausen, p. 15).

Dans la deuxième moitié du XIV^e siècle, un autre danger venant de l'Est menaçait l'Albanie et toute l'Europe. Les Turcs ottomans, qui avaient déjà occupé Adrianopolis en 1362, intervinrent dans les Balkans en prenant Vlora en 1417, ce qui leur donna l'accès à la mer Adriatique. Dans les documents médiévaux concernant le danger turc, on trouve la mention d'Apollonia tout comme celle du golfe de l'Ambracie comme points de départ de l'armée turque vers l'Italie. (Bessario, N.C. Oraciones de

gravissimis periculis, quae Reipublica Christianae a Turcis iam tum imndere providebat ... , Romae 1543, p.21). On trouve une autre mention d'Apollonia également dans la bataille du Sultan Mehmet en Apulie. (Lucanus, A.J. *De gestis rerum Neapo*, Neapoli 1566, p.41, 49).

Apollonia, en tant que centre de culture et de traditions antiques, a été remarquée par l'humaniste italien du XV^e siècle Siriaque d'Ancone. Lors de la visite que ce voyageur a réalisée en Albanie du Sud en 1435, il a rassemblé des objets antiques et a copié des inscriptions, dont une inscription d'Apollonia (CIL, III, 1-601 cf ; aussi P.C. Sestieri, *Mbishkrime latine të Shqipërisë, në studime e tekste dega II arkeologjike nr. 1 Tirana 1943, p.10 ; H.Ceka e S.Anamali, Mbishkrime latine të pabotuara të Shqipërisë, in BUSHT, Sh. Sh. 1, 1961, p.106 et note 6).*

Une importante information sur Apollonia nous est donnée par le célèbre humaniste albanais Marin Barleti. Dans son œuvre sur la vie de Georges Kastriot Skanderbeg, il mentionne les noms de quelques villes susceptibles d'accueillir le sommet de Lezha consacrant l'Union des Albanais contre les Turcs. Parmi les villes importantes de l'époque telles que Kruja, Danja, Lisos et Zhabjak, il mentionne également Apollonia. A l'époque de Skanderbeg, Apollonia faisait partie des possessions des Muzaka, une des familles les plus connues de l'époque.

Pendant presque deux siècles (XVII-XVIII ss.), durant l'occupation ottomane, Apollonia tombe quasiment dans l'oubli. Dans la guerre entre les Turcs et Venise en 1570-1571, les deux parties considéraient Apollonia comme un point stratégique. (Gratianus, A.M. *De bello cyprio*, V, Roma 1624, p.132). Un autre historien du XVII^e siècle considère Apollonia comme une ville ancienne importante au moment des invasions turques. (Sansovino, F., *Historia universale dell'origine et della guerra Turchi, in Venetia 1654, p.153, 302).*

Mais les siècles ont donné leur verdict. L'antique splendeur ne fait que diminuer jusqu'à ce que la grande ville majestueuse tombe à l'abandon, et pendant des siècles, ses ruines serviront de carrières pour les matériaux de construction. Outre les pillages et les destructions dus à l'intervention de l'homme, la nature a également été sévère avec la ville. Les terribles tremblements de terre qui ont frappé le littoral albanais ont également atteint la ville d'Apollonia en 1273, 1284, 1444 et 1617. (H.& H. Buschhausen, p. 69-70 et la bibliographie des notes 62-65).

La fin du XVIII^e et le début du XIX^e siècles marquent le début de la renaissance d'Apollonia. Des voyageurs étrangers tels que Pouqueville et Leake cherchent et trouvent les traces de la ville antique près du village de Pojani. C'est à ce moment qu'une autre histoire commence, celle des recherches dans la ville antique d'Apollonia, mais cela fera l'objet d'un autre récit.

Dans l'historique d'Apollonia, le XX^e siècle marque l'époque des fouilles archéologiques systématiques. L'organisation de ce colloque est précisément un honneur rendu au talentueux archéologue français Léon Rey, qui, il y a 80 ans, entreprit des fouilles intensives à Apollonia. Grâce à ses fouilles durant 14 ans il a mis à jour l'odéon, le portique, le monument des Agonothètes, etc... qui sont des perles rares de l'Antiquité, non seulement pour Apollonia, mais pour l'Albanie toute entière. Ces merveilleux monuments rivalisent dignement avec les découvertes de nombreuses villes de l'univers méditerranéen.